



Shkolla për Aktivizëm

Qendra e Burimeve për Shoqëri Civile në Kosovë

INFORMATA TË PËRGJITHSHME MBI SHKOLLËN
KOHËZGJATJA: QERSHOR - KORRIK 2026 (2 MUAJ)

MODULET

Çdo modul është dizajnuar për t'u organizuar në dy ditë të plota.

- 1** Qeverisja e brendshme për OShC-të
- 2** Integrimi gjinor
- 3** Vlerësimi i ndikimit dhe ngritja e fondeve
- 4** Diversifikimi i burimeve financiare
- 5** Teknikat e mobilizimit të komunitetit
- 6** Avokimi pjesëmarrës

1. OBJEKTIVI

Shkolla për Aktivizëm është një hapësirë për edukim profesional dhe rritje të aktivizimit, e cila synon zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave të OShC-ve me bazë në komunitet. Qëllimi i Shkollës është fuqizimi i prezencës së këtyre organizatave në komunitetet ku veprojnë dhe në proceset e politikëbërjes.

Kurrikula dhe ofrimi i programit janë zhvilluar duke ndjekur një qasje holistike, sipas së cilës OShC-të e përzgjedhura do të marrin pjesë në trajnime dhe seminare për ngritjen e kapaciteteve në kuadër të 6 moduleve. Këto module mbulojnë tema kyçe, si: qeverisja e brendshme dhe menaxhimi financiar, teknikat e mobilizimit të komunitetit, vlerësimi i ndikimit, ngritja e fondeve dhe diversifikimi i burimeve, si dhe avokimi pjesëmarrës dhe integrimi gjinor.

2. PJESËMARRËSIT

Çdo vit, një grup prej 20 OShC-ve që përfaqësojnë komunitete të ndryshme nga rajone të ndryshme të Kosovës përzgjidhen për të ndjekur Shkollën për Aktivizëm. Për të qenë pjesë e programit, organizatat duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Të jenë organizata të shoqërisë civile të regjistruara në Kosovë, që veprojnë në përputhje me legjislacionin dhe angazhohen për zhvillimin e shoqërisë civile.
- Të kenë një angazhim aktiv dhe lidhje të drejtpërdrejtë me komunitetin, duke kontribuar në zhvillimin e tij dhe duke krijuar mundësi për përfshirjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese vendimmarrëse.
- Të kenë identifikuar nevojën për forcimin e kapaciteteve të brendshme, përfshirë përmirësimin e proceseve të menaxhimit dhe zhvillimin e rregulloreve dhe strukturave që mbështesin funksionimin e organizatës.

3. METODOLOGJIA

- Ligjërata
- Prezantime interaktive
- Ushtrime praktike
- Analizë e rasteve studimore
- Vizita në terren
- Detyra individuale dhe grupore
- Përdorimi i materialeve vizuale
- Sesione me folës të ftuar

4. REZULTATI

Pas përfundimit të 6 moduleve të Shkollës për Aktivizëm, organizatat pjesëmarrëse pritet të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë dhe përmirësojnë organizimin e brendshëm, qeverisjen dhe menaxhimin financiar të organizatës së tyre.
- Përdorin në mënyrë më efektive teknikat e mobilizimit të komunitetit.
- Krijojnë rrjete dhe bashkëpunime me organizata dhe grupe të ndryshme për interesa dhe qëllime të përbashkëta.
- Hartojnë një strategji ose plan të qartë të aktiviteteve për realizimin e qëllimeve organizative.
- Zhvillojnë strategji më të mira për ngritjen e fondeve, si dhe për planifikimin dhe implementimin e projekteve.
- Identifikojnë nevojat e komunitetit duke përdorur metoda dhe mjete të përshtatshme.
- Marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal dhe qendror, me një kuptim më të thellë të metodave të avokimit pjesëmarrës.
- Integrojnë qasjen gjinore në aktivitetet e brendshme dhe në bashkëpunimet me palët e jashtme.

5. PËRFITIMET

Gjatë dhe pas përfundimit të Shkollës për Aktivizëm, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të përfitojnë:

- Mentorim dhe këshillim të vazhdueshëm nga ekspertë të Qendrës së Burimeve, për adresimin dhe avancimin e çështjeve specifike të organizatës së tyre.
- Rrjetëzim dhe bashkëpunim me organizata të tjera të shoqërisë civile për nisma të përbashkëta

6. CERTIFIKIMI

Pas përfundimit të programit, secila organizatë pjesëmarrëse do të pajiset me një certifikatë të pjesëmarrjes, që vërteton përfundimin me sukses të 6 moduleve të trajnimit.



Shkolla për Aktivizëm

Qendra e Burimeve për Shoqëri Civile në Kosovë

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT

KOHËZGJATJA: QERSHOR - KORRIK 2026 (2 MUAJ)

DATA*	MODULET	TEMAT
10-11 qershor	Moduli 1: Qeverisja e brendshme për OShC-të	<ul style="list-style-type: none">- Kuptimi, përkufizimi dhe dallimi i qeverisjes dhe menaxhimit- Kuptimi dhe dallimi mes Qeverisjes dhe Menaxhimit- Marrëdhëniet ndërmjet organeve jo-ekzekutive dhe ekzekutive- Cikli i jetës së organizatës- Konflikti i interesit
17-18 qershor	Moduli 2: Integrimi gjinor	<ul style="list-style-type: none">- Kuptimi i integritimit gjinor dhe rëndësia e tij në shoqërinë civile- Aplikimi i integritimit gjinor në politikat dhe strukturat organizative- Analiza gjinore dhe ndikimi në planifikimin e projekteve- Monitorimi dhe vlerësimi nga perspektiva gjinore- Rëndësia e pjesëmarrjes së grave dhe grupeve të marginalizuara në vendim-marrje
24-25 qershor	Moduli 3: Vlerësimi i ndikimit dhe ngritja e fondeve	<ul style="list-style-type: none">- Rëndësia, potencialet dhe sfidat e monitorimit dhe vlerësimit në vlerësimin e ndikimit- Identifikimi i konteksteve dhe objektivave të ndryshme të M&E- Procesi sistematik i zhvillimit të sistemeve të M&V dhe lidhja e tyre me misionin e organizatës- Opsione të ndryshme për sigurimin e fondeve
1-2 korrik	Moduli 4: Diversifikimi i burimeve financiare	<ul style="list-style-type: none">- Informacion teorik dhe praktik mbi analizën e modeleve të ndryshme të mbledhjes së fondeve- Metodot për hartëzimin e grupeve të përkrahësve të organizatës dhe kauzës së saj- Prezantimi i kornizës për mbledhjen e fondeve- Mjetet dhe metodat e përshtatshme për sigurimin e fondeve nga individët dhe bizneset
8-9 korrik	Moduli 5: Teknikat e mobilizimit të komunitetit	<ul style="list-style-type: none">- Përkufizimi i komunitetit dhe dimensionet e tij- Metodot për mobilizimin e komunitetit dhe ndërtimin e rrjeteve- Teknikat për zhvillimin e dialogut ndërmjet komunitetit dhe OSHC-ve- Strategjitë për fuqizimin e qytetarëve për të adresuar nevojat e tyre- Përdorimi i komunikimit efektiv në mobilizimin e komunitetit
15-16 korrik	Moduli 6: Avokimi pjesëmarrës	<ul style="list-style-type: none">- Demokracia dhe avokimi pjesëmarrës- Përfshirja e komunitetit në punën e OSHC-ve- Cikli i politikëbërjes dhe roli i qytetarëve në vendimmarrje- Mekanizmat formalë për pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal dhe qendror- Mekanizmat për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e integritimit të Kosovës në BE

*Ju lutem vini re se datat për realizimin e moduleve janë tentative dhe mund të ndryshojnë. Për çdo ndryshim eventual do të jeni të informuar me kohë.

Qendra e Burimeve për Shoqëri Civile në Kosovë, është projekt i cili bashkë-financohet nga Bashkimi Evropian dhe Suedia dhe zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Community Building Mitrovica (CBM).